

BASHKIA E TIRANËS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomik: “Klajger” shpk & “Kupa” shpk
Adresa: Kamëz, Bathore 6, pranë kopshtit të fëmijëve, Bathore 6: Tiranë.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim “Rikonstruksion i magazinës së Arkivës (Faza e II- të)”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonstruksion i magazinës së Arkivës (Faza e II- të)”.

Fondi limit: 5.287.999 (pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr.28 datë 23.12.2014 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”.

Kohëzgjatja e kontratës: 2 (dy) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 09.11.2015, ora 13:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 43 datë 02.11.2015.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme
• Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Kthella” shpk

NIPT J69303023D

Vlera e ofertës = **4.947.824 (katër milion e nëntëqind e dyzetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzetë e katër) lekë pa TVSH.**

2. Operatori Ekonomik “Shëndelli” shpk

NIPT K07924803N

Vlera e ofertës = **0 (zero) lekë**

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Ndrekaj” shpk & “Ndërtim Montim e Re” shpk

NIPT J69102313S& NIPT J73312211D

Vlera e ofertës = **4.082.637** (katër milion e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

**4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Klajger” shpk & “Kupa” shpk
NIPT K51423028P & NIPT K51615512C**

Vlera e ofertës = **3.437.170** (tre milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Ndrekaj” shpk & “Ndërtim Montim e Re” shpk

- Shoqëria Ndërtimi Montimi e Re në vërtetimin e xhiros mesatare të tre viteve të fundit nuk ka të përfshirë vitin 2012 por vetëm vitin 2013,2014 dhe 2015 deri në muajin shtator duke rënë në kundërshtim me kriteret e vecanta për kualifikim pika 2 e kapacitetit ekonomik dhe financiar.
- Shoqëria “Ndërtimi Montimi e Re” sh.p.k nuk ka paraqitur çertifikatat ISO 9001:2008, ISO 14001:2004, OHSAS 18001:2007, PAS 99:2012 duke mosplotësuar pikën 6, 7, 8, 9 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim, të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Në mbështetje të nenit 74 pika 3, Kreu VIII i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: “.....*kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje....*”. Në këtë mënyrë shoqëria “Ndërtimi Montimi e Re” sh.p.k bie në kundërshtim me pikën 2 të nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 30, Kreu III i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të cilat parashikojnë paraqitjen e certifikatave, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standartet për menaxhimin e mjedisit.
- Shoqëria Ndërtimi Montimi e Re për muajin Nëntor 2014 nuk ka paraqitur Formularin e deklarimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore (FDP), Formularin e deklarimit të të ardhurave nga punësimi (TAP) si edhe urdhër pagesën për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore duke mos përmbushur kështu kriteret e vecanta për kualifikim pika 4 gërma (iii) dhe (iv) dhe (v) pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.
- Shoqëria Ndërtimi Montimi e Re për muajin Shtator 2015 nuk ka paraqitur urdhër pagesën për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore duke mos përmbushur kështu kriteret e vecanta për kualifikim pika 4 gërma (v) pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.
- Mjeti Kamionçine me targa AA 127HJ e praqitur nga shoqëria “Ndrekaj” shpk ka kapacitet mbajtës nën1 ton (800 kg), pra nuk plotëson kushtin e përcaktuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pika 10 që kamionçina të ketë kapacitet mbajtës 1-2 ton. Në këtë mënyrë shoqëria “Ndrekaj” sh.p.k bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të Ligjit 9643, datë

20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 26 pika 8 gërma (c), Kreu III i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të cilat parashikojnë aftësinë teknike të operatorëve ekonomikë në realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik “Shëndelli” shpk

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Shëndelli” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të nenit 53, pika 3 dhe 5, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “Klajger” shpk & “Kupa” shpk, me adresë Kamëz, Bathore 6, pranë kopshtit të fëmijëve, Bathore 6, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej; **3.437.170 (tre milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitëria “Dëshmorët e Kombit”, Nr.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **4.947.824 (katër milion e nëntëqind e dyzetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzetë e katër) lekë pa TVSH**, siç parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 16.11.2015

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë nuk është paraqitur asnjë ankesë.